"TË THEM TË VËRTETËN..." KEQINFORMIMI BRENDA RRETHIT FAMILJAR

Në ditët tona, kur bombardohemi nga të gjitha anët nga informacione, nuk është aq e thjeshtë të dallojmë faktet nga trillimet. Kjo vlen edhe për komunikimin brenda familjes, ku dezinformatat përhapen shpejt dhe vigjilenca është e ulët. Është mirë që të luftohet dezinformimi edhe brenda rrethit familjar me biseda dhe diskutime të mirëinformuara.

Ndikimi:

- Duhet të kuptojmë rolin e rëndësishëm që luan eliminimi i dezinformatave brenda familjes për nxitjen e mendimit kritik dhe vendimmarrjes së mirëinformuar. Kur flasim për vullnet të lirë dhe vendimmarrje, është e rëndësishme që të kuptojmë ndikimin e faktorëve të ndryshëm mbi individin, duke përfshirë algoritmet, flluskat e filtrimit dhe përmbajtjen e seleksionuar. Duke iu kundërvënë në mënyrë aktive dezinformatave jemi disi më të mbrojtur nga këto ndikime, për t'u siguruar që vendimet tona po merren vërtetë me vullnetin tonë të lirë dhe janë të bazuara në informacione të sakta.

Nxitja e komunikimit të hapur:

- Krijo një ambient të ngrohtë dhe tolerant ku anëtarët e familjes të ndihen rehat kur bisedojnë mbi tema të diskutueshme. Kjo mund të arrihet duke krijuar një atmosferë besimi dhe mirëkuptimi ku të afërmit e dinë se diskutimet nuk do të shpërthejnë në debate ose grindje.
- Duhet të inkurajohet dialogu i hapur dhe debati i respektueshëm, duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit të këndvështrimeve të ndryshme.

Verifikimi i burimeve:

- Fol me pjesëtarët e familjes për rëndësinë e verifikimit të informacionit nga burime të besueshme.
- Mësoji si të verifikojnë faktet duke konfirmuar informacionin me burime të besueshme si revista akademike, media me reputacion dhe faqet zyrtare të qeverisë në internet.

Kundershto idetë e gabuara:

- Mos ki frikë që t'i kundërshtosh me argumente dhe edukatë idetë e gabuara dhe paragjykimet.
- Jep argumente të bazuara në prova dhe nxiti anëtarët e familjes që të analizojnë dhe luftojnë supozimet dhe idetë e tyre fikse, si paragjykime, stereotipe dhe logjika e gabuar që të ngulitet në mendje si pasojë e presionit mediatik.

Jep shembullin personal:

- Jep shembullin pozitiv duke analizuar në mënyrë kritike një informacion përpara se ta shpërndash tek të tjerët. Mendohu mirë para se të bësh share!
- Sillu në mënyrë të përgjegjshme në internet duke verifikuar faktet përpara se të ripostosh ose dërgosh mesazhe në platformat e mediave sociale.

Promovo edukimin mediatik:

- Ndihmoji pjesëtarët e familjes që të përvetësojnë aftësitë e edukimit mediatik për të dalluar burimet e besueshme të informacionit nga mediat jo të besueshme. Ki parasysh pesë pyetjet kryesore. Sa herë që një anëtar i familjes të dërgon një link të dyshimtë ose poston diçka që të duket se nuk është e saktë, bëji këto pyetje: Kush e ka krijuar këtë mesazh? Çfarë teknikash janë përdorur për të tërhequr vëmendjen? Si mund ta perceptojnë të tjerët këtë mesazh? Çfarë stili jetese, vlerash dhe këndvështrimesh janë përfshirë ose janë lënë jashtë këtij mesazhi? Dhe, pyetja më e rëndësishmja, pse është dërguar ky mesazh?
- Bisedo me ta mbi teknikat që përdoren zakonisht për dezinformata, si titujt karrem (clickbait), imazhet e manipuluara dhe të dhënat e paraqitura në mënyrë gjysmake dhe të seleksionuar – pra gjithçka që kemi mësuar nga kjo seri materialesh infografike.

Respekto mendimin ndryshe:

- Mos harro se jo të gjithë pjesëtarët e familjes kanë të njëjtat pikëpamje ose ide, por kjo nuk përbën problem. Është e rëndësishme të kuptojmë se në çfarë vlerash besojnë e të dimë çfarë pikëpamjesh kanë, por gjithësesi duhet të jemi në gjendje të bisedojmë me ta duke treguar respekt.
- Duhet të respektojmë këndvështrimet e njëri-tjetrit ndërsa përpiqemi të gjejmë gjuhën e përbashkët bazuar në informacione të sakta dhe vlera të përbashkëta.

unesco
Financuar nga Bashkimi Evropian
Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias